



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.192/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Muhamet Rexha dhe Nenad Lazic, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a. – Divizioni i Furnizimit, me seli në P., kundër debitorit KPL Lokal F.P., me seli në V., me objekt kontesti borxh, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.04.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

### A r s y e t i m i

Ish Gjykata Komunale në Vushtrri, tani Degë e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a. – Divizioni i Furnizimit, me aktvendimin E.nr.963/07 të datës 12.12.2007, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Ish Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Ndaj këtij aktvendimi kreditori ka paraqitë ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.999/12 të datës 22.03.2013, ka aprovuar ankesën e kreditorit, ka prishur

aktvendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri E.nr.963/07 të datës 12.12.2007 dhe çështjen ia ka kthyer Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri në rishqyrtim dhe vendosje.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, me aktvendimin CP.nr.314/2013, të datës 26.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale - Dhomave të Shkallës së Parë-Departamentit për Çështje Ekonomike.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.343/24 të datës 26.03.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega Vushtrri, për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., dhe debitorit KPL Lokal F.P., Në pikën II të dispozitivit është vendosur që për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a. – Divizioni i Furnizimit, me seli në P., më datë 30.11.2007 ka parashtruar propozim për ekzekutim në ish Gjykatën Komunale në Vushtrri, tani degë e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitor KPL Lokal F. P., me seli në V., që t'ia paguaj shumën prej 1262.40 €. Gjykata pasi që ka pranuar propozimin për ekzekutim të paraqitur nga kreditori, me aktvendimin E.nr.963/07 të datës 12.12.2007, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, e po ashtu, Gjykata e Apelit ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe e ka prishur aktvendimin e shkallës së parë duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe vendosje. Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega Vushtrri ka nxjerrë aktvendimin CP.nr.314/2013 të datës 26.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore për të gjykuar është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për këto arsye:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”* Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet që: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”*. Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për faktin se kreditori në këtë çështje përmbartimore kur është lejuar përmbartimi dhe lënda ka qenë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri edhe pse ka paraqitë ankesë, e njëjta gjykatë, me aktvendimin me aktvendimin E.nr.963/07 të datës 12.12.2007, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore në këtë çështje përmbartimore, e po ashtu, Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.999/12 të datës 22.03.2013 ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe e ka prishur aktvendimin e shkallës së parë duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe vendosje, e pastaj Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri me aktvendimin e lartcekur është shpallur jokompetente për të vendosur. Pasi që në rastin konkret kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kaloj te përmbartuesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP-së, andaj Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit.

Pasi që për mjetet juridike të paraqitura është vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta, andaj sipas vlerësimit edhe të Gjykatës Supreme kjo çështje përmbartimore, nuk është në kompetencë të Gjykatës Komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkesave të lëndës e bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur sipas propozimit për përmbarim është Gjykata Themelore Mitrovicë - Dega në Vushtri.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.192/2024, datë 25.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari

Zenel Leku